

ZYRA E PËRFAQËSUESIT

FJALA

ANTONELLA SCOLAMIERO

PËRFAQËSUESI I UNICEF

WORKSHOP PËR PROCESIN E HARTIMIT TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2017-2021

20 Prill 2016

Hotel "XHEKO Imperial"

E dashur Znj. Muça, Drejtor i INSTAT-it,
Të dashur kolegë,

Vlerësoj dhe mbështes plotësisht iniciativën e Institutit të Statistikave në organizimin e workshop-it të sotëm për të treguar angazhimin dhe bashkëpunimin e aktorëve të rëndësishëm në procesin e hartimit të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare që përfshin pesë vitet e ardhshme.

UNICEF punon në mbarë botën për të promovuar të drejtat dhe përmirësuar jetën e çdo fëmije në çdo rrethanë. Për mbi më tepër se 70 vjet, UNICEF-i ka mësuar se problemet të cilat nuk maten shpesh mbeten të pazgjidhura. Kjo është arsyeja pse, si një organizatë botërore lider e të drejtave të fëmijëve, ne përkrahim fuqimisht përmirësimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e të dhënave për fëmijët.

Për të theksuar rolin e të dhënave, me synim drejtimin e axhendës së ndryshimit në interesin më të mirë të fëmijës, përfitoj nga rasti për të nxjerrë në pah një gjetje të rëndësishme të një studimi të ri të UNICEF-it mbi "Mbrotja Sociale për Mirëqenien dhe të Drejtat e Fëmijëve" i cili mbulon 30 vende dhe territore në Evropën Qendrore e Lindore, Azinë Qendrore dhe Kaukaz. Studimi nxjerr në pah se fëmijët të cilët qendrojnë shumë prapa zhvillimit në shoqëri, përfitojnë më shumë kur vendet investojnë në mbrotje sociale më efektive.

UNICEF në Shqipëri ka ngritur vazhdimisht shqetësimet e saj në lidhje me nevojat dhe sfidat për matjen reale, vlerësimin dhe raportimin e gjendjes së fëmijëve dhe grave në këtë vend. Këto kërkesa shkojnë bashkërisht me nevojën për të monitoruar progresin drejt arritjes së objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare të përcaktuara (përfshirë edhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) dhe angazhimeve për promovimin e mirëqenies së grave dhe fëmijëve. Mungesa e të dhënave cilësore, të krahasueshme për periudha të caktuara kohore, ka çuar në këtë sfidë të matshmërisë.

Është e rëndësishme të njohim se strategjitë për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për fëmijët duhet të marrin në konsideratë perspektivën e të drejtave të fëmijëve. Të dhënat për, dhe në lidhje me fëmijët janë ndërsektoriale dhe trajtojnë shumë dimensionet e përvojave të fëmijëve. Prandaj, duhet të përfshihet e trajtohet si një prioritet i ndërthurur në të gjitha kapitujt përkatës të Programit të Statistikave Zyrtare të Shqipërisë.

Përgëzoj INSTAT-in për përafrimin e Programit të ardhshëm të Statistikave Zyrtare me kërkesat e Compendium-it statistikor 2015 të Eurostat. Do të doja të përfitoj nga ky rast për të kujtuar të gjithë, që të sjellin axhendën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në prioritetet e programeve të tyre të punës dhe të angazhohen për të

prodhuar të dhëna për këtë qëllim. Kuadri i treguesve për të drejtat e fëmijëve, nën kujdesin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, gjithashtu duhet që të udhëheqë këtë proces.

Krahas procesit të përcaktimit të të dhënave të nevojshme, ne kemi besim se rëndësi do t'i jepet zbatimit të metodologjisë së duhur, në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe me parimet e cilësisë statistikore.

Ndërsa ofrimi i të dhënave ka qenë fokusi kryesor i axhendës statistikore kombëtare, vëmendje duhet gjithashtu t'i jepet kërkesës për të dhëna/tregues për hartimin e politikave. Qeveria aktuale duhet të përgëzohet për këmbënguljen ndaj kulturës së planifikimit të bazuar mbi fakte/tregues dhe të orientuar drejt qëllimit. Kjo do të realizohet në kuadër të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale specifike në vijim të finalizimit - dhe që do të shoqërohen me planet dhe treguesit monitorimit - në vitin 2016. Megjithatë, transformimi i qëllimeve të mira në praktikë, bazuar edhe në kapacitetet e duhura në ofrimin e shërbimeve publike, do të mbetet një detyrë ambicioze në vitet që do të vijnë.

Më lejoni të shpreh mbështetjen dhe angazhimin e UNICEF-it në avancimin më tej të punës së përbashkët të të gjithë ne këtu, që do të vazhdojë në muajt në vijim me qëllim hartimin e një dokumenti planifikimi strategjik të qendrueshëm, të Programit të Statistikave Zyrtare të Shqipërisë.

Faleminderit.